

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

PER FONDET E PERFITUARA DHE SHPENZIMET E KRYERA

NGA PARTIA LIDHJA PER DREJTESI DHE PROGRES

GJATE FUSHATES PER ZGJEDHJET PER KUVEND 2013

Tirane 12 Shtator 2013

PERMBLEDHJE E LENDES

- Raporti i Audituesit te Pavarur
- Shenime mbi Deklaratat Financiare
 1. Te pergjithshme
 2. Politikat operuese
 3. Rregullat e vleresimit
 4. Te ardhurat
 5. Shpenzimet
 6. Likuiditetet
 7. Kreditoret e palikujduar
 8. Dokumentacioni dhe rregjistrimi i fondeve jo publike
 9. Ngjarje te mevonshme

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar : **-Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:**
 Pallati i Kongreseve , Tirane
-Partise Lidhja per Drejtesi dhe Progres
 Rruga e Dibres, Pallati AK, kati i II-te,tek Selvia, Tirane

Te nderuar Zoterinj:

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”i ndryshuar, ne zbatim te Vendimit te KQZ date 02/08/2013 si dhe Kontraten e Sherbimit nr.6476 date 12/08/2013 te lidhur me kete institucion, kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur per fondet e perfituara dhe shpenzuara nga Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres (qe do ti referohemi ne vijim me inicialet LDP) ne zgjedhjet per Kuvend te dates 23 Qershor 2013.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Pergatitja e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzuara nga LDP gjate fushates zgjedhore per Kuvend 2013 eshte pergjegjesi e drejtimit te saj.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, SNA 800 “Mbi angazhimet e auditimit per qellime te vecanta”. Keto standarte

kerkojne qe auditimi te planifikohet dhe te kryhet per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, te fakteve dhe dokumentatve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Ai perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te ndjekura, vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres se fondeve te arketuara dhe shpenzuara per fushaten zgjedhore 2013.

Ne cmojme se auditimi yne perben nje baze te aresyeshme per te shprehur opinionin tone mbi Pasqyrat Financiare per fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga PartiaLidhja per Drejtesi dhe Progres gjate fushates zgjedhore per Kuvend 2013.

Sipas opinionit tone, bazuar ne auditimin e kryer, me siguri te aresyeshme, pervec opinionit te shprehur ne shenimin 4.b, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare te fondeve te perftuara dhe shpenzuara nga Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres gjate fushates zgjedhore per Kuvend zhvilluar me 23 Qershor 2013, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte.

Lejla SHAHU (DOBI) ,

Ekspert Kontabel i Rregjistruar

Lic.174 date 22/01/2008

Adresa : Rr. Islam Alla, P.67/9, Tirane

SHENIME MBI DEKLARIMET FINANCIARE

1 Te pergjithshme

Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres eshte rregjistruar me Vendim nr.1950 date 02/3/2012 te Gjykates se Rrethit Tirane, Kryetar i saj eshte Z. Elmaz Sherifi.

Organizimi dhe drejtimi

Instancat dhe organet qendrore te PLDP jane:

- Kuvendi Kombetar;
- Keshilli i Pergjithshem;
- Kryesia e Partise
- Kryetari i Partise
- Sekretariati
- Komisioni Qendror i Interpretimit e zbatimit te Statutit
- Komisioni Qendror i zgjedhjeve ne Parti e zgjedhjet e per pushtetin

Burimet e financimit te Partise jane:

- Te ardhurat nga kuotizacionet;
- Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me ligjislacionin per financimin e partive politike;
- Ndhimat dhe dhuratat e antaresise dhe te perkrahesve te PLDP;
- Çdo e ardhur tjeter qe nuk bie ne kundërshtim me ligjislacionin per financimin e partive politike.

Selia e Partise eshte ne Tirane, Rruga e Dibres, Pallati AK, kati i II-te, tek Selvia.

2 Politikat operuese

Drejtimi i Partise, ka operuar per kete peridudhe qe auditojme ne ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2009 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", ligjin 8580 date 17/02/2000 "Per partite politike" i ndryshuar, dhe ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i dates

29.04.2004, dhe ne konformitet aktet nenligjore, me objektin e veprimtarise per te cilin eshte krijuar, dhe programit te caktuar nga organet qendrore.

3 Rregullat e vleresimit

-Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare

Bazuar ne auditimin e kryer, rezulton se te ardhurat jane evidentuar e deklaruar ne baze te arketimeve faktike, kontabiliteti eshte ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit, duke zbatuar parimin e kujdesit, nderkohe qe shpenzimet jane evidentuar e deklaruar ne ne momentin e kryerjes se tyre.

Administrimi i fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera eshte bere i ndare selia qendrore nga deget partise ne rrethe, per rrjedhoj edhe pasqyrat financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore 2013, jane pergatitur ne dy grupe:

-Monedha e raportuar

Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbartur ne dokumentacionin fillestar ne monedhat All, Usd dhe Euro ose ne kontribute ne natyre. Pasqyrat jane pergatitur ne Leke.

-Taksat dhe Kontributet .

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore te punonjesve dhe per Tatimin mbi te ardhurat personale. Gjithashtu per perudhen qe auditojme ka llogaritur dhe mbajtur tatimin ne burim per disa sherbime dhe ambiente private te marra me qera .

FONDET E PERFITUARA DHE TE SHPENZUARANGA PLDP NE ZGJEDHJET PER KUVEND 2013

4 TE ARDHURAT

NR	Burimet e perfitimit te fondeve per zgjedhjet per Kuvend 2013	Shenime	Vendi i depozitimit	Lloji i monedhes			Kursi	Total ne leke
				Leke	Usd	Ne natyre		
I	Buxheti i shtetit	4.a	Banka					
II	Burimet e veta	4.b	Arka	500.000				500.000

Lejla SHAHU(DOBI) Ekspert Kontabel i Rregjistruar, Lic.174 date 22/01/2008

III	Sponsorizimet							
	Sponsorizimet	4.c	Banka					
	Sponsorizimet	4.c	Arka					
IV	Te ardhura nga kuotat	4.d	Arka	490.535				490.535
V	Te ardhura te tjera	4.e	Banka					
	TOTALI PLDP			990.535				990.535

4.a Buxheti i Shtetit

Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres nuk ka përfituruar fonde publike per te përballuar fushate elektorale per zgjedhjet per Kuvend 2013.

4.b Burime te Veta

Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres ka përdorur fonde nga burimet e veta per te përballuar fushate elektorale per zgjedhjet per Kuvend 2013. Keto burime i referohen te ardhurave nga kontributi i Kryetarit te Partise Z. Elmaz Sherifi ne shume 500.000 leke dhe kjo e ardhur eshte transaksion i kryer ne formen e cash-it (me arke). Ky eshte nje transaksion qe bie ne kundërshtim me nenin 120 te Udhëzimit nr.24 date 02/09/2008 i ndryshuar "Per Procedurat Tatimore ne RSH".

4.c Sponsorizimet.

Per fushaten zgjedhore per Kuvend 2013, Partia LDP nuk ka perfituar sponsorizime.

4.d Te ardhura nga kuotat.

Per fushaten zgjedhore per Kuvend 2013, selia PLDP ka përdoruar te ardhurat nga kuotat e antarsise per financimin e shpenzimeve. Shuma prej 490.535 lekesh, qe i referohet kuotave te anetaresise, eshte kryer nepermjet arkës dhe jane shuma nen vleres 100.000 leke, qe sipas Ligjit nuk eshte detyrim per tu deklaruar

4.e Te ardhura te tjera

Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres nuk ka bere aplikimin per terheqje te fondeve per fushaten zgjedhore 2013 te transfreuar nga KQZ. Partia operon me Banken Credins me numer 00000378961.

5 SHPENZIMET

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Shuma e fatures	Shpenzime te papaguara	Totali i shpenzimeve
1	Shpenzime karta anetaresie, flamuj te vegjel, etj	5.f	Arke	169.130		169.130
2	Shpenzime vule dixhitale	5.g	Arke	4.500		4.500
3	Shpenzime broshura	5.h	Arke	75.000		75.000
4	Shpenzime stilolapsa	5.i	Arke	12.500		12.500

5	Shpenzime transmetimi ne televizion	5.j	Arke	15.000		15.000
6	Shpenzime kuti votimi + dhome votimi	5.k	Arke	3.000		3.000
7	Shpenzime aktivitet tek salla Balsh (Tirana International Hotel)	5.l	Arke	66.360		66.360
8	Shpenzime adezive	5.m	Arke	5.600		5.600
9	Shpenzime stative kamere Hana	5.n	Arke	4.200		4.200
10	Shpenzime cdoganimi	5.o	Arke	40.245		40.245
11	Shpenzime qera (prill 2012- gusht 2013)	5.p	Arke	595.000		595.000
	Totali			990.535		990.535

Totali i shpenzimeve te kryera nga PLDP, per fushaten zgjedhore 2013 eshte 990.535 nga te cilat te pa likujduara nuk ka.

Lidhur me shpenzimet e mesiperme, u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjitha elementet e mesiperme, dhe u siguruam se:

Jane te mbartura ne dokumentacion te rregullt ligjor te njohura nga ligjet ne fuqi si ai per kontabilitetin dhe ato fiskale.

Klasifikimi i tyre dhe paraqitja ne pasqyren financiare eshte i sakte, duke dhene nje imazh te qarte mbi destinacionin e perdorimit te tyre.

Nga shpenzimet e kryera e te ekspozuara ne pasqyren e mesiperme, vlen te japim disa shpjegime te shkurtra per secilin elementet, si :

5.h Shpenzime karta anetaresie, flamuj te vegjel, etj.

Gjate fushates per zgjedhjet per Kuvend 2013 jane shpenzuar per blerje karta anetaresie,flamujpodium forexine shumen 169.130 leke. Pagesa eshte bere me banke, kunderjet fatures doganore, jane paguar taksat konform Ligjit. Pagesa e taksave doganorene shumen 40.245 leke eshte rregjistruar si **shpenzim doganore** ne shenimin 5.o referuar Tabeles se Shpenzimeve (me siper).

5.g shpenzime vule dixhitale

Jane paguar 4.500 leke per Kompanine Media Graph,per vuledixhitale. Pagesa eshte bere me para ne dore kundrejt fatures jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.h shpenzime broshura

Shuma e ketij shpenzimi eshte 75 000 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.i shpenzime stilolpsa

Shuma e ketij shpenzimi eshte 12.500 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.j shpenzime transmetimi ne televizion

Shuma e ketij shpenzimi eshte 15.000 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.k shpenzime kuti votimi + dhome votimi

Shuma e ketij shpenzimi eshte 3.000 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.l shpenzime aktivitet tek salla Balsh (Tirana International Hotel)

Shuma e ketij shpenzimi eshte 66.360 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.m shpenzime adeziv

Shuma e ketij shpenzimi eshte 5.600 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.n shpenzime stative kamera Hana

Shuma e ketij shpenzimi eshte 4.200 leke, pagesa eshte bere me arke kundrejt faturave jo ligjore te leshuar nga shitesi.

5.p shpenzime qera

Partia Levizja per Drejtesi dhe Progres ka nje kontrate qeraje per zyrat e marra me qera ne vleren 35.000 leke ne muaj. Partia ka shlyer rregullisht sipas Ligjit detyrimet ligjore. Ky detyrim eshte shlyer dhe deklaruar per periudhen ne fjale.

6 LIKUJDITETET

Ne mbyllje te fushates zgjedhore gjendja e likujditeve ne llogarite eshte zero.

A. Levizjet dhe gjendja e likujditeve ne PLDP.

3.a.1 Gjendja e likuiditeteve ne fund te periudhes

Pershkrimi	Monedha	Kursi	vlera lek	Vlera eur	Totali ne lek
Arka	Leke	1	0	0	0
Banka					
Totali			0	0	0

Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet per Kuvend 2013 nuk ka terhequr fondet e transferuara nga KQZ per fushaten e zgjedhjeve per Kuvend te dates 23 qershor 2013.

Gjithashtu duhet te theksojme se per perballimin e shpenzimeve te fushates zgjedhore te 23 Qershorit 2013 Partia Lidhja per Drejtesi dhe Progres ka kryer arketime me arke. Shumat e arketuar kane qene me te vogla se 100 000 leke she pagesat e bera jane nen kufirin e lejuar.

B. Levizjet e likujditeve ne Partine Lidhja per Drejtesi dhe Progres.

Nr.	Emertimi	Hyrjet ne leke	Daljet ne leke	Gjendja ne leke
1	Selia qendrore Tirane	990.535	990.535	0
Totali		990.535	990.5350	0

7 KREDITORE TE PALIKUJDUAR:

Nuk ka kreditor te pa likuiduar.

8 DOKUMENTACIONI DHE RREGJISTRIMI I FONDEVE JO PUBLIKE

Rregjistrimi i fondeve jopublike te perfshira gjate fushates zgjedhore te 23 Qershorit 2013 eshte bere ne rregjistrin e posacem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se duke pasqyruar te gjitha shumat e perfituara sipas natyres konform Ligjit dhe destinimin e ketyre te ardhurave ne formen e shpenzimeve.

9 NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Lejla SHAHU (DOBI)

Ekspert Kontabeli Rregjistruar

Licence nr.174 date 22/01/2008

Adresa : Rr. Islam Alla, P.67/9, Tirane